



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**  
**Nr. 321, datë 17.09.2020**

**PËR**  
**MIRATIMIN E RISHPËRNDARJES SË FONDEVE BUXHETORE NË SHPENZIME**  
**PERSONELI, TË PROGRAMIT 3310 "BUXHETI GJYQËSOR"**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në nenin 12, pika 5 e ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në ligjin nr. 9936, date 26.6.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 10296, date 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar,

**V E N D O S I:**

1. Rishpërndarjen e fondeve buxhetore të pagave "Shpenzime Personeli", brenda programit "Buxheti Gjyqësor" të shumës prej 3,500,000 lekë, duke pakësuar fondin e pagave të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, përkatësisht 2,500,000 lekë dhe 1,000,000 lekë dhe duke shtuar fondin e "Shpenzimeve të personelit" për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit dhe Sekretari i Përgjithshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**